

# Programi i Reformës Ekonomike (PRE) - Vështrim i shkurtër

## ÇFARË ËSHTË PRE-JA?



Programet e Reformës Ekonomike (PRE) konsiderohen si shtylla kurrizore e politikës ekonomike të një vendi – që nënkupton RËNDËSINË



Në praktikë, ato janë dokumente me mbi 200 faqe, që përbëhen nga 7 kapituj dhe 2 shtojca, 40+ tabela – që nënkuptojnë KOMPLEKSITET



Mbi 100 persona marrin pjesë në hartimin e PRE-së, me shumë palë të interesit të angazhuara në proces – që nënkupton GJITHËPËRSHIRJEN

PRE-të tregojnë se si të ruhet stabiliteti makro-fiskal dhe si të zbatohen reforma strukturore për të adresuar dobësitë e identifikuara në ekonomi dhe të ndihmojnë shoqërinë të bëhet më e qëndrueshme.

PRE-të përfaqësojnë nivelin më të lartë të angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në çështjet socio-ekonomike dhe përbëjnë bazën për dialog mbi politikat ekonomike. Zbatimi i reformave të identifikuara në PRE-të dhe udhëzuesit të politikave të miratuara së bashku me vendet anëtare të BE-së është çelësi për të përmirësuar konkurrencën, për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe për të lehtësuar përfshirjen sociale, si dhe për të përmbushur kriteret ekonomike në procesin e anëtarësimit. Çdo vit këto kritere analizohen nga afër në përputhje me metodologjinë e zgjerimit. Për të arritur progres të prekshëm në këto reforma, PRE-të duhet të bëhen element thelbësor në planifikimin e politikave të brendshme.

## KAPITUJT E PRE-SË

|   |  |
|---|--|
| 1. KUADRI I PERGJITHSHEM I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT            | Përshkrim i shkurtër i sfidave kryesore ekonomike të vendit dhe i prioritetëve të politikave.  |
| 2. ZBATIMI I UDHËZUESIT TË POLITIKAVE                           | Pasqyrë e përgjithshme e masave të marra ose të planifikuara për zbatimin e udhëzuesit të politikave që u miratuan në Dialogun Ekonomik dhe Financiar. |
| 3. KUADRI MAKROEKONOMIKE  | Analiza dhe projeksione të trendeve ekonomike.   |
| 4. KUADRI FISKALE   | Objektivat dhe masat kryesore të politikave fiskale së bashku me kuadrin buxhetore për vitin aktual dhe dy vitet e ardhshme.                           |
| 5. REFORMAT STRUKTURE   | Deri në gjashtë reforma strukturore që adresojnë sfidat dhe pengesat kryesore për konkurrencën dhe zhvillimin gjithëpërfshirës.                        |
| 6. KOSTIMI DHE FINANCIMI I REFORMAVE STRUKTURE                  | Përmbledhje e kostove dhe burimeve të financimit të reformave strukturore nga Kapitulli 5.   |
| 7. ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT | Sqarimi i procesit institucional për përgatitjen dhe miratimin e PRE-së, si dhe për konsultimin publik.  |

Kapitujt 3, 4 dhe 5 duhet të jenë në përputhje me masat për zbatimin e udhëzuesit të politikave dhe duhet t'u referohen atyre dhe ndikimit të tyre të pritshëm.

# KUADRI I PERGJITHSHEM I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE DHE UDHËZUESI I POLITIKAVE

## PALËT E INTERESIT DHE AFATET

### Grupi i punës PRE-së:

- koordinatori i PRE-së
- koordinatorët në nivel të ministrive, kapitujve ose të fushave të reformës
- lidhja me koordinatorin kombëtar të IPA-s

### Palët e tjera të interesit:

- komuniteti i biznesit, partnerët shoqërorë dhe shoqëria civile, parlamenti i vendit dhe autoritetet rajonale dhe lokale




Fillimi i konsultimeve publike:

**Nëntor**

Dorëzimi i PRE-së:

**15 janar**



Kapitulli 5 është pjesa më e rëndësishme e PRE-së. Ai duhet të analizojë pengesat dhe të identifikojë gjashtë reforma strukturore në këto fusha:

1. Konkurrenca
2. Qëndrueshmëria dhe elasticiteti
3. Kapitali njerëzor dhe politikat sociale

Identifikimi i pengesave dhe priorizimi i reformave kërkon një përkushtim të fuqishëm politik për PRE-në në nivelin më të lartë.

Reformat duhet të adresojnë udhëzuesin e politikave për të cilat është rënë dakord bashkërisht me BE-në dhe çështjet kryesore të theksuara në Raportin e Progresit për sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike për anëtarësim në BE.

# UDHËZUESI PRAKTIK PËR HARTUESIT E MASAVE TË PRE-SË



## KËRKESAT PËR PARAQITJEN E NJË MASE

Shënimi udhëzues i PRE-së kërkon paraqitjen e një mase që përfshin:

- analizën e gjendjes aktuale, sfidat dhe pengesat relevante për masën
- përshkrimin e objektivave të masës dhe aktivitetëve të planifikuara
- treguesit e rezultateve dhe ndikimin e pritshëm të masës
- kostot e vlerësuara të zbatimit dhe burimet financiare në dispozicion
- identifikimin e rreziqeve për zbatim dhe mënyrat për t'i adresuar ato
- lidhjen e masës me angazhime të tjera strategjike

Ju do të duhet të përgatisni të gjitha këto elemente në një format të ofruar nga koordinatori i PRE-së.



## PËRMIRËSIMI I NJË MASE EKZISTUESE APO PARAQITJA E NJË MASE TË RE?

Shumica e masave janë vazhduar nga PRE-ja e fundit. Kjo është e kuptueshme, pasi periudha e zbatimit të tyre zakonisht është tri vjet. Megjithatë, një masë që është zbatuar ose që është bërë aktivitet i rregullt i ministrisë, duhet të zëvendësohet me një të re. Duhet të caktohet një afat specifik për përfundimin e zbatimit të masave dhe duhet të jenë në dispozicion burimet e nevojshme për zbatim.

Vendimi nëse do të përmirësohet një masë ekzistuese apo do të paraqitet një e re duhet të merret së bashku me koordinatorin e PRE-së, pasi ata e njohin më mirë logjikën dhe prioritetet e e pergjithshme te PRE-se. Është e këshillueshme që të konsultoheni me vendim-marrësit në ministrinë tuaj, pasi ata ndoshta duan të paraqesin prioritetet e reja në PRE.



## HAPAT PËR PËRMIRËSIMIN E NJË MASË EKZISTUESE

### HAPI 1

#### PËRCAKTIMI I STATUSIT AKTUAL

Plotësoni tabelën 11 të aneksit të PRE-së për të parë progresin në zbatimin e masës.

Përdorni të dhënat dhe njohuritë tuaja për të përditësuar analizën e fushës suaj të reformës dhe gjeni vlerat më të fundit të disponueshme për treguesit e rezultateve të masës. Kjo do t'ju informojë për ndryshimet tashmë të arritura dhe sfidat që mbeten për t'u adresuar.

### HAPI 2

#### KONSIDERONI PËRMIRËSIMET QË DUHEN BËRË

Merrni parasysh komentet e bëra nga Komisioni Evropian (KE) për masën tuaj dhe fushën e reformës në vlerësimin e tyre për PRE-në e fundit. Shikoni udhëzimin e politikave të marrë nga rishikimi kolegjial i PRE-së së fundit për të parë nëse ai lidhet me masën tuaj. Konsultohuni me koordinatorin e PRE-së për atë që duhet përmirësuar për të adresuar komentet e KE-së, udhëzimin politikave dhe kërkesat e Shënimit udhëzues të PRE-së.

Nëse zbatimi i masës ka qenë i dobët, diskutoni me personat përgjegjës për aktivitetet dhe hapat që mund të ndërmerri të gjithë për të përmirësuar gjendjen. Nëse masa nuk jep rezultatet e pritura, konsideroni rishikimet e aktivitetëve të masës, për shembull shënjestrim dhe planifikim më të mirë, zgjerim të fushë-veprimit ose rritjen e burimeve për masën.

### HAPI 3

#### PËRMIRËSIMI (RISHKRUAJTJA E) I MASËS

Ju mund të përdorni tekstin ekzistues nga PRE e fundit, por kini kujdes që të bëni përmirësimet e nevojshme:

- përshtateni masën për të pasqyruar komentet dhe udhëzimet nga KE-ja dhe nga koordinatori i PRE-së
- në rast të zbatimit të dobët, shpjegoni arsyet dhe hapat e ndërmarrë për adresimin e tyre
- mos shtoni automatikisht aktivitete për një vit tjetër; kjo arsyetohet vetëm kur vonohet zbatimi ose kur nevojitet më shumë kohë për të arritur objektivat
- përditësoni kostot e vlerësuara dhe burimet financiare, si dhe vlerat e treguesve të rezultateve
- konsultohuni me udhëzimet e dhëna më poshtë për hartimin e elementeve të ndryshme të masës dhe bëni përmirësimet sipas nevojës



## HAPAT PËR PARAQITJE TË NJË MASË TË RE

### HAPI 1 ARSYETONI DHE PËRKUFIZONI MASËN

Para hartimit, konsultohuni me vendimmarrësit në ministrinë tuaj dhe me koordinatorin e PRE-së për përmbajtjen e masës së re. Në këtë proces, përcaktoni qartë çështjet që do të adresojë masa, objektivat e saj, aktivitetet që do të ndërmerren dhe rezultatet e pritshme në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale.

Kur propozoni një masë të re për PRE-në, ju duhet të arsyetoni pse ajo është prioritet - për shembull, duke e vlerësuar masën kundrejt kriterëve të priorizimit të propozuara nga OECD-ja. Mbani në mend se një masë e reformës duhet të sjellë ndryshime thelbësore në praktikën dhe politikën aktuale. Duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatim dhe masa duhet të jetë mjaftueshëm e fortë për të sjellë përmirësime të prekshme të gjendjes aktuale.

### HAPI 2 ANALIZONI GJENDJEN E TANISHME

Përdorni të dhënat dhe njohuritë tuaja për të hartuar një analizë të fushës suaj të reformës, me qëllim që të arsyetoni nevojën për masën e re. Shmangeni ofrimin e detajeve dhe të dhënave të shumta, përqendrohuni në çështjet kryesore dhe atë që duhet përmirësuar. Shpjegoni arsyet pse gjendja aktuale nuk është e kënaqshme. Këto arsye quhen “pengesa” dhe paraqesin sfidat që masa duhet të adresojë.

### HAPI 3 PËRSHKRUANI MASËN DHE AKTIVITETET E SAJ

Përshkrimi i masës duhet të përfshijë objektivat e saj dhe duhet ta lidh atë me sfidat që i adreson. Ai duhet t'i jap lexuesit një kuptim të qartë të asaj që do të bëhet dhe pse. Nëse masa është pjesë e një reforme më të gjerë sektoriale ose e lidhur me masa të tjera, edhe kjo duhet të shpjegohet.

Aktivitetet duhet të planifikohen për vitin aktual dhe dy vitet e ardhshme. Shmangni përsëritjen e të njëjtave aktivitete për të tri vitet - aktivitetet duhet të pasojnë njëra-tjetrën në një sekuençë logjike të zbatimit. Numri i aktiviteteve nuk duhet të kalojë 7 (por mund të jenë më pak). Përshkrimet e aktiviteteve duhet të jenë të shkurtër dhe të theksojnë qartë fushëveprimin e aktivitetit, rezultatet e planifikuara dhe institucionin përgjegjës.

### HAPI 4 PËRZGJIDHNI TREGUESIT E REZULTATEVE DHE SHPJEGONI NDIKIMIN E PRITUR

Zhvilloni një shpjegim logjik se si masa juaj do të përmirësojë gjendjen aktuale. Bazuar në këtë ‘logjikë të ndërhyrjes’, hartoni shpjegimin e ndikimit të pritshëm ekonomik dhe në punësim të masës. Përpiquni të përcaktoni sasine e ndikimit me të dhëna (p.sh. BPV, eksport). Ky është çelësi për të treguar pse masa është prioritet.

Treguesit e rezultateve duhet të lidhen me objektivat ose me ndikimin e pritshëm të masës, e jo me zbatimin e aktiviteteve individuale. Objektivat për treguesit duhet të shprehin realisht përmirësimet e pritshme të gjendjes aktuale. Për masat që kanë nevojë për më shumë kohë për të arritur të gjitha rezultatet dhe ndikimin e dëshiruar, viti i synuar për treguesit mund të jetë përtej periudhës trevjeçare të PRE-së.

### HAPI 5 LLOGARITNI KOSTOT E ZBATIMIT DHE BURIMET E FINANCIMIT NË DISPOZICION

Për të kontrolluar realizueshmërinë e masës, duhet të vlerësoni kostot e zbatimit për çdo aktivitet të masës. Duhet të llogarisni vetëm kostot shitesë - në praktikë, kjo do të thotë se nuk keni nevojë të llogaritni pagat e personelit ekzistues dhe kostot indirekte.

Kostot duhet të krahasohen me financimin e siguruar për masën në buxhetin afatmesëm dhe nga burimet e jashtme siç është IPA. Disponueshmëria e burimeve duhet të konfirmohet nga Ministria e Financave dhe koordinatori i IPA-s. Masat për të cilat burimet e disponueshme nuk i mbulojnë të gjitha kostot mund të përfshihen në PRE vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në marrëveshje me koordinatorin e PRE-së.

### HAPI 6 KONSIDERONI RREZIQET PËR ZBATIMIN

Rreziqet e zbatimit më së shpeshti lidhen me kapacitetin e pamjaftueshëm për zbatim, dështimet në koordinim, mungesën e mbështetjes nga vendimmarrësit politikë, mungesën e bashkëpunimit nga palët kryesore të interesit, rritjet e papritura të kostos ose financimin e pamjaftueshëm. Ju duhet të identifikoni rreziqet më të rëndësishme dhe të shpjegoni se çfarë hapash do të ndërmerren për t'i adresuar ato.

### HAPI 7 FINALIZONI DRAFTIN E MASËS

Për versionin përfundimtar të PRE-së, ju duhet të përmirësoni draftin e masës suaj duke marrë parasysh komentet e marra nga koordinatori i PRE-së dhe nga palët e interesit, si dhe komentet e dhëna nga KE-ja gjatë misionit të tyre në vjeshtë dhe nga ekspertët e CEF-it dhe TAIEX-it.



## BURIME TË DOBISHME

- Vlerësimi i ndikimit > [Manuali për vlerësimin e ndikimit ekonomik të reformave strukturore në PRE \(CEF\)](#)
- Priorizimi i masave > [Mjeti i priorizimit i PRE \(OECD\)](#)
- Analiza e gjendjes > [Mjeti diagnostikues i PRE \(OECD\)](#)
- Përshkrimi i masës > [Këshilla dhe sugjerime për të shkruar një përshkrim të mirë të një reforme strukturore \(CEF\)](#)
- Treguesit e rezultateve > [Manuali për përzgjedhjen e TKP-ve dhe monitorimin e rezultateve të reformave strukturore në PRE \(CEF\)](#)
- Kostoja dhe financimi > [Udhëzuesi metodologjik për përcaktimin e kostos së reformave strukturore \(CEF\)](#)